

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-032/14**

**Prishtinë,  
11 Nëntor 2015**

Në çështjen juridike të

**B.L.**

Branka Deletica bb,  
Adrijevića  
Serbi

*Pala ankuese*

**kundër**

**A.B.**

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin, dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK) nr. KPCC/D/R/215/2013 të datës 21 gusht 2013 lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje: AKP) me numrin KPA29220, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 11 Nëntor 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B.L. kundër vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/R/215/2013 të datës 21 gusht 2013.
2. Vërtetohet vendimi i KKPK-së nr. KPCC/D/R/215/2013 sa i përket kërkesës nr. KPA29220.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 31 maj 2007, B.L. (në tekstin e mëtutjeshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e një banese me sipërfaqe prej 32, 67 m<sup>2</sup>, që ndodhet në rrugën “B. Vukmirović 210” në Pejë (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar)
2. Paraqitësi i kërkesës dorëzoi *ndër tjerash* në AKP:
  - Kontratën e blerjes Nr .9555/93 të lidhur më 30 shtator 1993 ndërmjet Komunës së Pejës, në cilësinë e shitësit, dhe S.V. , si blerës i pronës së kërkuar.
  - Çertifikatën e vdekjes nr.203-19915/2002-VI të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Pejës më 28 tetor 2002 që tregon se S.V. (bashkëshortja e S.V. ) ka vdekur më 16 qershor 1999.
  - Aktvendimin e trashëgimisë T.nr. 33/02 të lëshuar nga Gjykata Paralele e Komunës së Pejës më 29 nëntor 2002, në bazë të cilit B.L. ka trashëguar pronën e kërkuar nga motra e gjyshes e tij e ndjerë, Spasa Vučković.
  - Kontratën e para-blerjes të lidhur ndërmjet R.D. në cilësinë e shitëses së pronës së kërkuar dhe A.B. si blerës më 12 korrik 2004. Kontrata nuk është e vërtetuar në gjykatë.
  - Çertifikatën e vdekjes nr. VII-203-3-151/2011 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Pejës më 19 shtator 2011, që tregon se S.V. (bashkëshorti i S.) ka vdekur më 7 prill 1999.
  - Autorizimin Nr. 74/2013 të lëshuar më 4 shkurt 2012 përmes së cilës B.L. e ka autorizuar A.H. që të veprojë në emrin e tij para Agjencisë Kosovare të Pronës.

3. Më 30 mars 2008, AKP-ja identifikoi pronën e kërkuar, që doli se ajo ishte e uzurpuar.
4. Më 4 korrik 2008, A.B. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala përgjegjëse në kërkesë) ka marrë pjesë në procedurën para AKP-së, duke pretenduar se ai e ka blerë pronën nga pronari i ligjshëm.
5. Pala përgjegjëse në kërkesë ka dorëzuar *inter alia* në AKP:
  - Kontratën e para-blerjes të lidhur ndërmjet R.D. në cilësinë e shitëses së pronës së kërkuar dhe A.B. si blerës më 12 korrik 2004. Kontrata nuk është e vërtetuar në gjykatë.
  - Vendimet për përcaktimin e tatimit në pronë Nr. 432-1/3643 dhe 436-98/3643 të lëshuar nga Administrata Shtetërore e të Hyrave Publike – Departamenti për vlerësimin dhe vjeljen e të hyrave publike në Pejë, që vërtetojnë se S.V. e ka paguar tatimin në pronë për vitet 1995 dhe 1998.
  - Deklaratën e R.D. të datës 18 prill 2006 ku deklaroi se ajo e ka dorëzuar denoncimin penal kundër B.L. dhe se të gjitha provat që ajo i ka dorëzuar në DBP janë të vërteta.
  - Kontrata për mbajtje të përhershme e lidhur më 3 maj 1999 ndërmjet S.V. si përfitues i mbajtjes dhe R.D. si ofruese e mbajtjes së përhershme. Kontrata përmban një vulë që tregon se është vërtetuar në gjykatë, por nuk përmban numër reference të Gjykatës Komonale të Pejës.
6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së më 20 mars 2013 kërkoi nga paraqitësi i kërkesës që të dorëzojë një aktvendim valid të trashëgimisë dhe prova shtesë për ta dëshmuar të drejtën e tij pronësore për të cilën pretendon por paraqitësi i kërkesës nuk i ka dorëzuar provat e kërkuara. (Shih faqe 208 të dosjes).
7. AKP-ja vërtetoi se prona e kërkuar paraprakisht kishte qenë objekt i vendosjes nga KKBP-ja sipas kërkesës së B.L. it. Kërkesa është hedhur poshtë nga KKBP-ja në vendimin e saj HPCC/D/189/2005/C të datës 30 prill 2005. Sipas paragrafëve 12 dhe 13 të vendimit grupor që zbatohet posaçërisht për kërkesën, L. ka dështuar që të paraqesë prova të dokumentuara për të dëshmuar se ai e ka pasur posedimin e pronës në fjalë apo ndonjë provë të së drejtës pronësore, e cila i ka dhënë të drejtën që ta merr posedimin e pronës së kërkuar. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga KKBP-ja në vendimin e saj HPCC/REC/95/2007 të datës 26 mars 2007. Në paragrafin 6 të vendimit grupor thuhet se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë të re që është ligjërisht relevante, e cila nuk është shqyrtuar nga Komisioni gjatë vendosjes rreth kërkesës. Prandaj, arsyetimi për vendimin mbetet sikurse është paraqitur në vendimin e shkallës së parë.
8. KKPK-ja vendosi në vendimin e vet KPCC/D/R/215/2013 që ta refuzojë kërkesën. Në arsyetimin e saj (paragrafi 42) thuhet se paraqitësi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë që do ta mbështeste kërkesën e tij.
9. Vendimi i është dorëzuar B.L. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) më 29 nëntor 2013.

10. Pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 20 dhjetor 2013.
11. Ankesa i është dorëzuar A.B. ( në tekstin e mëtutjeshëm: pala përgjegjëse në ankesë) më 26 nëntor 2013. Vëllai i tij A.B. e pranoi ankesën por ai nuk mori pjesë në ankesë.

### **Pretendimet e palës ankuese**

12. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së i ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe të mangët faktet dhe e ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale.
13. Sipas palës ankuese ai është trashëgimtari ligjor pas vdekjes së S.V.. Prona e kërkuar ka qenë pronë e saj dhe ai është bërë pronar i së njëjtës pavarësisht kohës kur ai e ka fituar pronësinë faktike mbi të. Ai është trashëgimtari i vetëm dhe AKP-ja është dashur ta merr këtë fakt në konsideratë.
14. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta revokojë vendimin e refuzuar dhe ta kthejë në shkallën e parë për rishqyrtim.

### **Arsyetimi ligjor**

15. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendimit ankimor dhe pretendimeve të palës ankuese në përputhje me nenin 194 të LPK-së, konstatoi se ankesa është e pabazuar.
16. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e saj në faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka vërtetuar se pala ankuese ka dorëzuar një vendim trashëgimie që është lëshuar nga gjykata paralele në vitin 2002 e cila e mbështet kërkesën e palës ankuese. Megjithatë, Komisioni nuk i konsideron këto dokumente të lëshuara nga institucionet paralele si prova të vlefshme. Për më tepër, Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk kishte qenë në gjendje që të sigurojë *ex officio* ndonjë provë që mbështeste kërkesën e L-. Bazuar në këtë, KKPK-ja konstatoi se L. kishte dështuar që të vërtetojë ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar.
17. Gjykata Supreme vëren se Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore e kishte hedhur poshtë kërkesën e L- në vendimin e tij HPCC/D/189/2005/C të datës 30 prill 2005, dhe e kishte refuzuar kërkesën e tij për rishqyrtim në vendimin HPCC/REC/95/2007 të datës 26 mars 2007.
18. Ankesa nga Lončarević i përsërit të njëjtat pretendime që ai i kishte bërë para KKPK-së. Nuk është paraqitur ndonjë provë e re e rëndësishme së bashku me ankesën.

19. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë korrekte dhe të plotë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
20. Duke i pasur parasysh të lartcekurat, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

21. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

*Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit*

*Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it*

*Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*